



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 375 Prot.

Tiranë, më 06.05.2016

V E N D I M

Nr.53 datë 06.05.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Fier”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 128, datë 11.12.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Fier”,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 68, datë 02.07.2015, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Fier”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 128, datë 11.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Fier”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Fier, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të revokuar sipas ligjit aktet e mëposhtme, të cilat kanë lidhje me procesin e rekrutimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar:

- Aktin e emërimit nr.41/1, datë 17.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkur Fier, për punonjës in ***** në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve*” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
- Aktin e emërimit nr.69, datë 21.07.2014, për punonjës in ***** në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”, si dhe akteve për transferim në pozicione të shërbimit civil të nxjerra për këtë punonjës në bazë të Vendimit nr. 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkur Fier, “*Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015*” .
- Urdhër Komandimi në detyrë nr. 34, datë 17.03.2014, për punonjës in ***** në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”, si dhe akteve për transferim në pozicione të shërbimit civil të nxjerra për këtë punonjës, në bazë të Vendimit nr. 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkur Fier, “*Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015*” .

3. Pozicionet e mësipërme, sipas strukturës aktuale, “*Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve*”, “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”, dhe “*Specialiste Mjedisi në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”, duhet të shpallen pozicione të lira nga njësia përgjegjëse dhe të plotësohen sipas procedurave përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), fillimisht, duke parë mundësinë e plotësimit të tyre nga lista e pritjes (nga punonjësit e liruar për shkak të shkurtimit të vendeve të punës) dhe nëse kjo nuk do të jetë e mundur për mosplotësim të kërkesave apo kritereve të veçanta të pozicioneve të punës, të kalohet në fazat përkatëse të konkurrimit.

4. Nga ana e njësisë përgjegjëse të vlerësohet në raport me nevojat e institucionit, nëse është e nevojshme shpallja pozicioni i lirë për pozicionin “*Specialist*”, në “*Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, i liruar për shkak të ligjit, si i zgjedhur në organet e qeverisjes vendore, nga nëpunësi *****.

Në rastin e shpalljes së pozicionit të lirë, ai të plotësohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

5. Të nxirret akti i “*Pezullimit nga shërbimi civil*” për nëpunësen ***** dhe pozicioni i saj i punës “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit*”, të plotësohet sipas ligjit, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të përcaktuar në nenet 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, që rregullojnë këtë institut.

6. Të ndërpritet periudha e provës për punonjës in ***** aktualisht e punësuar në pozicionin “*Specialiste e INU, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”, dhe të deklarohet statusi i nëpunësit civil, në atë pozicion.

7. Njësia përgjegjëse duhet të nxjerrë aktet e transferimit/riemërimit, për punonjësit:

- ***** , në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
- ***** , në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
- ***** , në pozicionin “Drejtori i Drejtorisë së Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
- ***** , në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
- ***** , në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
- ***** , në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve”;
- ***** , në pozicionin “Specialist Finance, në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve”.

Me kalimin e afatit procedural prej 30 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Kërkesën nr.137, datë 16.02.2016 të Komisionerit, me anë të të cilës u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin e inspektuar në datën 27.02.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunësit ***** , dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.128, datë 11.12.2015, të Komisionerit, rezulton se:
 1. Është bërë revokimi i aktit të emërimit për nëpunësin ***** me detyrë “Specialist në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve” dhe me aktin e emërimit nr.46, datë 12.10.2015, nëpunësi është emëruar në pozicionin “Përgjegjës për transportin” në Drejtorinë e Shërbimeve, pas zhvillimit të procedurës së konkurimit të parashikuar në nenin 22 e vijues të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 2. Është bërë revokimi i aktit të emërimit për nëpunësin ***** me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale” dhe me aktin e emërimit nr.54, datë 01.10.2015, nëpunësi është emëruar në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit dhe Planifikimit Urban”, pas zhvillimit të procedurës së konkurimit të parashikuar në nenin 22 e vijues të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 3. Është bërë revokimi i Urdhrit të Komandimit për nëpunësen ***** me detyrë “Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale” dhe me aktin e emërimit nr. 50, datë 02.10.2015, nëpunësja është emëruar në pozicionin “Specialiste e Mjedisit Drejtorinë

Ekonomike dhe të Shërbimeve”, pas zhvillimit të procedurës së konkurimit të parashikuar në nenin 22 e vijues të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3, pozicionet e punës: “*Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve*”, “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”, dhe “*Specialiste Mjedisi në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”, janë shpallur pozicione të lira.
- ✓ Në lidhje me pikën 4, rezultoi se me Urdhrin nr.75, datë 10.09.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, pozicioni i punës “*Specialist*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës është shpallur si i lirë.
- ✓ Në lidhje me pikën 5 të vendimit, rezultoi se nga ana e njësisë përgjegjëse me aktin nr.825, datë 29.07.2015, është bërë propozimi për pezullimin e nëpunëses ***** , sipas rekomandimit të Komisionerit, por nga ana e titullarit të institucionit nuk ka dalë akti i pezullimit.
- ✓ Në lidhje me pikën 6 të vendimit, rezultoi se njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Fier ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë aktin e konfirmimit si nëpunës civil nr.1439, datë 31.12.2015, “*nëpunës civil*”, për punonjësen *****.
- ✓ Në lidhje me rekomandimin e pikës 7 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse në zbatim të rekomandimeve ka nxjerrë aktet e riemërimit për punonjësit e mëposhtëm:
 1. Riemërimi i nëpunësit ***** , me aktin nr.132, datë 31.12.2015, në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
 2. Riemërimi i nëpunëses ***** , me aktin nr.133, datë 31.12.2015, në pozicionin “*Specialiste*” në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
 3. Riemërimi i nëpunësit ***** , me aktin nr.136, datë 31.12.2015, në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Programim Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit.
 4. Riemërimi i nëpunëses ***** , me aktin nr.135, datë 31.12.2015, në pozicionin “*specialiste*” në Drejtorinë e Programim Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit.
 5. Riemërimi i nëpunëses ***** , me aktin nr.134, datë 31.12.2015, në pozicionin “*specialiste*” në Drejtorinë e Programim Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit.
 6. Riemërimi i nëpunësit ***** , me aktin nr.137, datë 31.12.2015, në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Financës.
 7. Riemërimi i nëpunëses ***** , me aktin nr.138, datë 31.12.2015, në pozicionin “*specialiste për financën*” në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 128, datë 11.12.2015 ,“ *Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Fier*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Fier**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Fier.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 128, datë 11.12.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Fier”*.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Fier dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA